

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Sektori i veprave civile, në bazë të nenit 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nenit 68 paragrafi (5) nga Rregullorja gjyqësore, më 23.11.2022, miratoi këtë:

M E N D I M J U R I D I K

Në kontestet për ndryshimin e lartësisë së asistencës, shpërblimi për dhënien e ndihmës juridike të një avokati do të përcaktohet sipas nenit 8 paragrafi (1) pika 7 nga Tarifa e Avokatëve.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Sektori i veprave civile, për shkak të harmonizimit të praktikës gjyqësore në zbatimin e ligjeve nga Gjykatat e Apelit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është dorëzuar kërkesë për miratimin e mendimit juridik për çështjen në vijim:

Në cilën bazë duhet të llogariten shpenzimet e procedurës në kontestet për asistencë.

Në fakt, për çështjen konkrete juridike është diskutuar në takimin e punës të Sektorëve civil së të gjithë Gjykatave të Apelit më 06.10.2021, por nuk është miratuar konkluzion.

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke diskutuar për çështjen e parashtruar juridike, e miratoi mendimin juridik për këto arsye:

Sipas nenit 194 të Ligjit për familje, gjatë konstatimit të nevojës nga asistenca e personit, gjykata do të merr parasysh, gjendjen e tij pronësore, aftësinë e punës, mundësinë e punësimit, pozitën shëndetësore, si dhe rrethanat tjera nga të cilat varet vlerësimi i nevojave të tij.

Në paragrafin (2) nga i njëjti nen, është përcaktuar se kur asistenca përcaktohet për fëmijë gjykata do të merr parasysh edhe moshën e fëmijës, si dhe për nevojat e shkollimit të tij.

Sipas nenit 194 paragrafi (3) të Ligjit për familje, gjatë konstatimit të mundësive të personit që është i detyruar të japë detyrim, gjykata do të merr parasysh të gjitha të ardhurat e tij dhe mundësitë e vërteta për fitimin e pagës dhe

nevojat personale të tij dhe obligimet ligjore në bazë të detyrimit ndaj personave tjerë.

Në bazë të nenit 201 nga i njëjti Ligj, personi i interesuar mund të kërkojë që ta rris, ta zvogëlojë apo ta anulojë detyrimin e caktuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të mëparshëm, nëse janë ndryshuar rrethanat në bazë të së cilave është miratuar aktgjykimi.

Në bazë të nenit 8 pika 7 nga Tarifa për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve, në procedurën e shkurorëzimit të martesës dhe konteste të tjera nga marrëdhëniet familjare, shpërblimi kap shumën prej 7.000,00 denarëve.

Gjatë vendimmarrjes së padisë për ndryshimin e lartësisë së detyrimit, gjykata konstaton se nëse janë ndryshuar rrethanat nga neni 194 të Ligjit për familje në bazë të së cilave është miratuar aktgjykimi, gjë e cila udhëzon në konkluzionin se bëhet fjalë për kontest të marrëdhënieve familjare, edhe pse objekt i kërkesës së padisë është ndryshimi i lartësisë së detyrimit që është përcaktuar në shumën në para. Detyrimi i anëtarëve të familjes dhe të afërmeve të tjerë është e drejtë dhe detyrë e tyre që gjatë caktimit të detyrimit dhe ndryshimit të tij nuk ka trajtim të kërkesës në para që rezulton nga marrëdhënia debitor – kreditor, por paraqet institut të rëndësishëm në të drejtën familjare.

Në kontestet për ndryshimin e lartësisë së asistencës sipas nenit 201 nga Ligji për familje, shpërblimi për përfaqësimin nga një avokat do të caktohet sipas nenit 8 paragrafi (1) pika 7 nga Tarifa, si për kontestet nga marrëdhëniet familjare.

Duke marrë parasysh të theksuarën, vijonte të miratohet mendimi i sipër theksuar juridik.

SEKTORI I VEPRAVE CIVILE